



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.35

17 prill

2012

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 34/2012 datë 29.3.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit për shërbimet ajrore..... 1653
Vendim i Kuvendit nr. 17/2012 datë 12.4.2012	Për zgjedhjen e zotit Elvis Çefa anëtar të Këshillit të Lartë të Drejtësisë..... 1664
Vendim i Kuvendit nr. 18/2012 datë 12.4.2012	Për njoftimin e krijimit të vakancës, për shkak të dorëheqjes nga mandati i deputetit Gjon Hill Bardhi dhe plotësimin e detyrimeve dhe të procedurës ligjore nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore për kandidatët e listave shumëmemërore të subjekteve zgjedhore, pas përfundimit të zgjedhjeve për Kuvendin 1664
Rezolutë e Kuvendit datë 29.3.2012	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), për vitin 2011..... 1665
Vendim i KM nr. 167, datë 29.2.2012	Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, 2013-2015..... 1666
Vendim i KM nr. 181, datë 13.3.2012	Për transferimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në pronësi të komunës Bushat, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1157, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të bordeve të kullimit, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”..... 1668
Vendim i KM nr. 184, datë 13.3.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe rrjetit rural të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 1671

Vendim i KM nr. 187, datë 6.3.2012	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Cangonj” dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë.....	1675
Vendim i KM nr. 188, datë 6.3.2012	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Malind” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	1675
Vendim i KM nr. 189, datë 13.3.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 419, datë 14.4.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”.....	1676
Vendim i KM nr. 190, datë 13.3.2012	Për Kodin e Hartimit, Adoptimit, Miratimit dhe Zbatimit të Standardeve.....	1677
Vendim i KM nr. 191, datë 13.3.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 150, datë 22.3.3007 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)”.....	1678
Vendim i KM nr. 192, datë 13.3.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Stravaj, të qarkut të Elbasanit.....	1679
Vendim i KM nr. 197, datë 22.2.2012	Për një shtesë në vendimin nr. 442, datë 18.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e shpenzimeve të palës shqiptare, pjesëmarrëse në operacionin ushtarak “Althea”, të Bashkimit European, në Bosnjë-Hercegovinë”.....	1680
Vendim i KM nr. 198, datë 22.2.2012	Për një shtesë në vendimin nr. 13, datë 7.1.2010 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e shpërblimit ditor për ushtarakët e Forcave të Armatosura të dërguar në Bosnjë-Hercegovinë, në kuadër të operacionit ushtarak “Althea”, të Bashkimit European”...	1681
Vendim i KM nr. 200, datë 21.3.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 839, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave për rimbursimin e akcizës së paguar dhe krijimin e kushteve lehtësuese, për ndërtimin e burimeve të prodhimit të energjisë elektrike, me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW”.....	1682
Vendim i KM nr. 201, datë 21.3.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 7, datë 4.1.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”.....	1683
Vendim i KM nr. 205, datë 21.3.2012	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme, të pronës nr. 818, me emërtim “Bateria kundërajrore”, me vendndodhje në Mbyet, Fier, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	1684

LIGJ
Nr. 34/2012

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT PËR
SHËRBIMET AJRORE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së shtetit të Katarit për shërbimet ajrore.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 29.3.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7387, datë 10.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT PËR SHËRBIMET AJRORE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e shtetit të Katarit,
duke qenë palë në Konventën e Aviacionit Ndërkombëtar Civil të hapur për nënshkrim në
Çikago, më 7 dhjetor 1944;
me dëshirën për të përfunduar një marrëveshje plotësuese të kësaj Konvente, për qëllimin e
vendosjes së shërbimeve ajrore ndërmjet dhe tej territoreve të tyre përkatëse,
kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe:

1. Termi “Konventa” është Konventa për Aviacionin Ndërkombëtar Civil e hapur për nënshkrim në Çikago, më 7 dhjetor 1944, dhe përfshin çdo aneks të miraturar në pajtim me nenin 90 të kësaj konvente dhe çdo ndryshim të anekseve ose konventës në pajtim me nenet 90 dhe 94 të saj, në masën që ato anekse dhe ndryshime kanë hyrë në fuqi ose janë ratifikuar nga të dyja palët kontraktuese.



2. Termi “marrëveshje” është kjo marrëveshje, aneksi që i bashkëlidhet asaj dhe çdo protokoll ose dokumente të ngjashme që ndryshojnë këtë marrëveshje ose aneks.

3. Termi “autoritete aeronautike” janë: në rastin e Qeverisë së shtetit të Katarit, Kryetari i Autoritetit të Aviacionit Civil dhe çdo person ose organ tjetër i autorizuar të përmbushë çdo funksion që tashmë ushtrohet nga ky kryetar ose funksione të ngjashme dhe në rastin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit që vepron në emër të Autoritetit të Aviacionit Civil ose, në të dyja rastet, çdo autoritet ose person tjetër me kompetenca për të përmbushur funksionet që tashmë ushtrohen nga ato autoritete.

4. Termi “linjë ajrore e caktuar” është një linjë ajrore që është caktuar dhe autorizuar në pajtim me nenin 4 të kësaj marrëveshjeje.

5. Termit “shërbim ajror”, “shërbim ajror ndërkombëtar”, “linjë ajrore” dhe “ndalim pa qëllim trafiku”, kanë kuptimet që u caktohen përkatësisht atyre në nenin 96 të Konventës.

6. Termi “kapacitet” në lidhje me një avion është aftësia mbajtëse e një avioni që ofrohet për një itinerar ose seksion itinerari; dhe në lidhje me një shërbim të përcaktuar ajror është kapaciteti i avionit, i përdorur për këtë shërbim, i shumëzuar me shpeshtësinë e fluturimeve, të operuara nga ky avion në një periudhë dhe itinerar apo seksion të caktuar itinerari.

7. Termit “shërbime të miratuara” dhe “itinerare të përcaktuara” kanë kuptimin përkatësisht të shërbimeve ndërkombëtare ajrore të planifikuara dhe të itinerareve të përcaktuara në aneksin e kësaj marrëveshjeje.

8. Termi “tarifë” janë çmimet që duhet të paguhet për transportin e pasagjerëve, bagazhit dhe mallrave dhe kushtet në të cilat zbatohen ato çmime, duke përfshirë çmimet dhe kushtet për agjencitë dhe shërbimet e tjera ndihmëse, por duke përjashtuar shpërblimin dhe kushtet për transportin e postës.

9. Termi “detyrimet e përdoruesit” janë tarifatat ose normat që vendosen për përdorimin e aeroporteve, pajisjeve të navigimit dhe shërbimet e tjera përkatëse që ofrohen nga njëra palë kontraktuese për tjetrën.

10. Termi “territor” në lidhje me një shtet ka kuptimin që i caktohet në nenin 2 të Konventës së Çikagos.

Neni 2

Zbatueshmëria e Konventës së Çikagos

Dispozitat e kësaj marrëveshjeje u nënshtrohen dispozitave të Konventës në masën që këto dispozita janë të zbatueshme për shërbimet ajrore ndërkombëtare.

Neni 3

Dhënia e të drejtave

1. Secila palë kontraktuese i jep palës tjetër kontraktuese të drejtat e mëposhtme në lidhje me shërbimet ajrore ndërkombëtare të planifikuara:

- a) të drejtën për të fluturuar mbi territorin pa ndaluar;
- b) të drejtën për të bërë ndalesa në territor pa qëllime trafiku.

2. Secila palë kontraktuese i jep palës tjetër kontraktuese të drejtat e përcaktuara në këtë marrëveshje për qëllimin e vendosjes së shërbimeve ajrore ndërkombëtare të planifikuara në itineraret e specifikuar në seksionin e përshtatshëm të grafikëve bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje. Këto shërbime dhe itinerare në vijim quhen përkatësisht “shërbimet e miratuara” dhe “itineraret e specifikuar”. Gjatë kryerjes së një shërbimi të miratuar në një itinerar të përcaktuar, linjat ajrore të caktuara nga secila palë kontraktuese gëzojnë, përveç të drejtave të parashikuara në paragrafin 1 të

këtij neni, të drejtën për të bërë ndalesa në territorin e palës tjetër kontraktuese në pikat e përcaktuara për atë itinerar në grafikët e bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje me qëllim të marrjes në bord dhe të disbarkimit të pasagjerëve dhe mallrave duke përfshirë postën, të kombinuar ose veçmas.

3. Asgjë në paragrafin 2 të këtij neni nuk konsiderohet t'u japë linjave ajrore të një pale kontraktuese, privilegjin e marrjes në bord, në territorin e palës tjetër kontraktuese, pasagjerë dhe mallra duke përfshirë postën e transportuar me shpërblim ose pagesë dhe të destinuar për një pikë tjetër në territorin e palës tjetër kontraktuese.

Neni 4

Caktimi dhe autorizimi

1. Secila palë kontraktuese ka të drejtën të caktojë me shkrim për palën tjetër kontraktuese një linjë ajrore për qëllimet e operimit të shërbimeve të miratuara në itineraret e specifikuar.

2. Me marrjen e një caktimi të tillë, pala tjetër kontraktuese, në pajtim me dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni, jep pa vonesë për linjën ajrore të caktuar autorizimet e përshtatshme për operimin.

3. Autoritetet aeronautike të një pale kontraktuese mund të kërkojnë që linja ajrore e caktuar nga pala tjetër kontraktuese t'i bindë ata që ajo është e kualifikuar të përmbushë kushtet e parashikuara në bazë të ligjeve dhe rregulloreve që zbatohen normalisht dhe në mënyrë të arsyeshme për operimin e shërbimeve ajrore ndërkombëtare nga këto autoritete në pajtim me dispozitat e konventës.

4. Secila palë kontraktuese ka të drejtën të refuzojë dhënien e autorizimit të operimit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni ose të caktojë ato kushte që ajo mund t'i çmojë të nevojshme për ushtrimin nga linja ajrore e caktuar të të drejtave të përcaktuara në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje, në çdo rast kur kjo palë kontraktuese nuk është e bindur që pronësia lëndore dhe kontrolli efektiv i asaj linje ajrore i është dhënë palës kontraktuese që ka caktuar linjën ajrore ose shtetasve të saj.

5. Nëse një linjë duhet të caktohet dhe autorizohet, ajo në çdo kohë mund të fillojë të ofrojë shërbimet e miratuara, me kusht që të jetë në fuqi një tarifë e përcaktuar në pajtim me dispozitat e nenit 8 të kësaj marrëveshjeje në lidhje me shërbimet.

Neni 5

Revokimi ose pezullimi i autorizimit të operimit

1. Secila palë kontraktuese ka të drejtën të revokojë një autorizim operimi ose të pezullojë ushtrimin e të drejtave të specifikuar në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje nga një linjë ajrore e caktuar nga pala tjetër kontraktuese, ose të caktojë ato kushte që ajo mund t'i çmojë të nevojshme për ushtrimin e këtyre të drejtave:

a) në çdo rast nëse nuk është e bindur që pronësia lëndore dhe kontrolli efektiv i asaj linje ajrore i është dhënë palës kontraktuese që ka caktuar linjën ajrore ose shtetasve të kësaj pale kontraktuese; ose

b) në rastin e mosrespektimit nga kjo linjë ajrore të ligjeve ose rregulloreve të palës kontraktuese që ka dhënë këto të drejta; ose

c) në rast se linja ajrore nuk operon në pajtim me kushtet e parashikuara sipas kësaj marrëveshjeje.

2. Përveç kur revokimi, pezullimi ose caktimi i menjëhershëm i kushteve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni është thelbësor për të parandaluar shkeljen e mëtejshme të ligjeve ose rregulloreve, kjo e drejtë ushtrohet vetëm pas konsultimeve me palën tjetër kontraktuese.



Neni 6

Përfshirja nga detyrimet doganore dhe detyrimet e tjera

1. Avioni i operuar në shërbimet ajrore ndërkombëtare nga linja ajrore e caktuar nga një palë kontraktuese, si dhe pajisjet e tyre të rregullta, furnizimet me karburant dhe lubrifikantë, dhe mallrat që mbahen në bordin e këtij avioni (duke përfshirë ushqimin, pijet, duhanin) përfshihen nga të gjitha detyrimet doganore, tarifave të inspektimit dhe detyrimet e tjera të ngjashme me mbërritjen në territorin e palës tjetër kontraktuese, me kusht që këto pajisje dhe furnizime të mbeten në bordin e avionit deri në atë moment që ato rieksporthen ose përdoren gjatë kohës së udhëtimit të kryer mbi atë territor.

2. Ata, gjithashtu, përfshihen nga këto detyrime, tarifa dhe pagesa, me përjashtim të pagesave që përputhen me shërbimet e kryera:

a) rezervat e avionit që merren në bord në territorin e një pale kontraktuese, brenda kufijve të caktuar nga autoritetet e kësaj pale kontraktuese dhe për përdorim në bordin e një avioni të nisur dhe të angazhuar në një shërbim ajror ndërkombëtar të palës tjetër kontraktuese;

b) pjesët e këmbimit dhe pajisjet e rregullta që jepen në territorin e një pale kontraktuese për mirëmbajtjen ose riparimin e avionit që përdoret në shërbimet ajrore ndërkombëtare nga linja ajrore e caktuar e palës tjetër kontraktuese;

c) karburanti dhe lubrifikantët që jepen në territorin e një pale kontraktuese për avionët që nisen të një linje të caktuar të palës tjetër kontraktuese të përfshirë në një shërbim ajror ndërkombëtar, edhe nëse këto pajisje duhet të përdoren në pjesën e udhëtimit të kryer mbi territorin e palës kontraktuese në të cilën ato merren në bord;

d) materialet publicitare, artikujt e uniformës dhe dokumentacioni i avionit që nuk kanë vlerë tregtare, të cilat përdoren nga linjat e caktuara të një pale kontraktuese në territorin e palës tjetër kontraktuese;

e) pajisjet e zyrës që jepen në territorin e një pale kontraktuese me qëllim që të përdoren në zyrat e linjës së caktuar të palës tjetër kontraktuese, me kusht që këto pajisje të jenë në dispozicion të atyre zyrave gjatë tre (3) vjetëve nga data e prezantimit të tyre në atë territor dhe që të zbatohet parimi i reciprocitetit.

Materialet e përmendura në nënparagrafët “a”, “b” dhe “c” më sipër mund të kërkohen mbahen nën mbikëqyrjen ose kontrollin doganor.

3. Pasagjerët, bagazhet dhe mallrat në transitin e drejtpërdrejtë në territorin e një pale kontraktuese dhe që nuk largohen nga zona e aeroportit të rezervuar për këtë qëllim u nënshtrohen një kontrolli shumë të thjeshtëzuar. Bagazhi dhe mallrat në transit të drejtpërdrejtë përfshihen vetëm nga detyrimet doganore dhe taksat e tjera të ngjashme.

4. Pajisjet e rregullta në fluturim, si dhe të gjitha materialet dhe furnizimet që mbahen në bordin e avionit të një pale kontraktuese mund të shkarkohen në territorin e palës tjetër kontraktuese vetëm me aprovimin e autoriteteve doganore të atij territori. Në këtë rast, ato mund të vendosen nën mbikëqyrjen e këtyre autoriteteve deri në atë moment që ato rieksporthen ose disponohen ndryshe në pajtim me rregulloret doganore.

Neni 7

Parimet që rregullojnë operimin e shërbimeve të miratuara

1. Linjat ajrore do të kenë mundësi të drejta dhe të barabarta për linjat ajrore të të dyja palëve kontraktuese për të operuar shërbimet e miratuara në itineraret e specifikuar ndërmjet territoreve të tyre përkatëse.

2. Në operimin e shërbimeve të miratuara, linja e caktuar e një pale kontraktuese merr parasysh interesat e linjës ajrore të caktuar nga pala tjetër kontraktuese, me qëllim që të mos ndikojë në mënyrë të parregullt në shërbimet që jep kjo e fundit plotësisht ose pjesërisht në të njëjtat itinerare.

3. Shërbimet e miratuara që jepen nga linjat e caktuara të palëve kontraktuese mbajnë një raport të ngushtë me kërkesat e publikut për transport në itineraret e caktuara dhe kanë si objektiv të tyre kryesor sigurimin, në një faktor të arsyeshëm ngarkese, e kapacitetit të përshtatshëm për të përmbushur kërkesat e tashme dhe të parashikuara në mënyrë të arsyeshme për transportin e pasagjerëve dhe mallrave duke përfshirë postën me origjinë ose destinacion territorin e palës kontraktuese që ka caktuar linjën. Realizimi i transportit të pasagjerëve dhe mallrave duke përfshirë postën e marrë në bord dhe që dorëzohet në pikat e itinerareve të specifikuar në territoret e shteteve të ndryshme nga ai që ka caktuar linjën, bëhet në pajtim me parimet e përgjithshme që kapaciteti ka të bëjë me:

- a) kërkesat e trafikut për në dhe nga territori i palës kontraktuese që ka caktuar linjën;
- b) kërkesat e trafikut të zonës në të cilën kalon shërbimi i miratuar, pas marrjes parasysh të shërbimeve të tjera të transportit të caktuara nga linjat e shteteve që përbëjnë zonën; dhe
- c) kërkesat e operimit të plotë të linjës.

Neni 8

Tarifat

1. Tarifat që caktohen nga linja e një pale kontraktuese për transportin për në ose nga territori i palës tjetër kontraktuese caktohen në nivele të arsyeshme, duke marrë parasysh të gjithë faktorët përkatës, duke përfshirë koston e operimit, fitimin e arsyeshëm dhe tarifën e linjave të tjera.

2. Tarifat paraqiten për aprovim tek autoritetet aeronautike të të dyja palëve kontraktuese të paktën dyzet e pesë (45) ditë para datës së propozuar për prezantimin e tyre. Në raste të veçanta, kjo periudhë mund të shkurtohet, sipas pëlqimit të autoriteteve përkatëse.

3. Ky aprovim mund të jepet shprehimisht. Nëse asnjë nga autoritetet aeronautike nuk ka shprehur mosmiratimin brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e paraqitjes, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, këto tarifa konsiderohen të aprovuara. Në rastin e shkurtimit të periudhës për paraqitje, sipas parashikimit të paragrafit 2, autoritetet aeronautike mund të bien dakord, që periudha brenda së cilës duhet të njoftohet çdo mosmiratim është të paktën tridhjetë (30) ditë.

4. Nëse gjatë periudhës së zbatueshme në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, asnjë autoritet aeronautik nuk i bën autoritetit tjetër aeronautik njoftim për mosmiratimin e tij, autoritetet aeronautike të të dyja palëve kontraktuese, pas konsultimeve, përpiqen të caktojnë tarifën me marrëveshje të përbashkët.

5. Nëse autoritetet aeronautike nuk mund të bien dakord për asnjë tarifë të paraqitur atyre sipas paragrafit 2 të këtij neni, ose për caktimin e ndonjë tarife sipas paragrafit 4 të këtij neni, mosmarrëveshja zgjidhet në pajtim me dispozitat e nenit 18 të kësaj marrëveshjeje.

6. Një tarifë e caktuar në pajtim me dispozitat e këtij neni mbetet në fuqi derisa të jetë caktuar një tarifë e re. Megjithatë, një tarifë nuk vazhdon duke u mbështetur në këtë paragraf për më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj pas datës në të cilën do të kishte skaduar.

7. Pa kufizuar zbatimin e konkurrencës së përgjithshme dhe ligjin për konsumatorin në çdo palë kontraktuese, ndërhyrja nga pala kontraktuese përfshin:

- a) parandalimin e tarifave ose praktikave të paarsyeshme diskriminuese;
- b) mbrojtjen e konsumatorëve nga tarifën që janë tepër të larta ose tepër kufizuese për shkak të abuzimit me pozitën dominuese ose praktikave në marrëveshje ndërmjet transportuesve ajrorë; dhe



c) mbrojtjen e linjave ajrore nga tarifat që janë tepër të ulëta për shkak të subvencionit ose mbështetjes së drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë nga qeveria.

Neni 9 **Aprovimi i orareve**

Linja e caktuar paraqet për aprovim tek autoritetet aeronautike të palës tjetër kontraktuese orarin e fluturimeve duke përfshirë tipin e avionit të përdorur, si dhe kapacitetin. Kjo duhet të paraqitet jo më vonë se 30 ditë para inaugurimit të fluturimeve të planifikuara. Kjo kërkesë zbatohet edhe për ndryshimet e mëvonshme. Në raste të veçanta, nëse është e nevojshme, afati kohor mund të shkurtohet pas konsultimeve ndërmjet autoriteteve të sipërpërmendura.

Neni 10 **Dhënia e statistikave**

Autoritetet aeronautike të palëve kontraktuese u paraqesin autoriteteve aeronautike të palës tjetër kontraktuese, me kërkesë të tyre, ato pasqyra periodike ose të tjera statistikore që mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme për qëllimin e rishikimit të kapacitetit që ofrohet në shërbimet e miratuara nga linjat ajrore të caktuara të palëve kontraktuese të përmendura së pari në këtë nen. Këto deklarime përfshijnë të gjithë informacionin që kërkohet për të përcaktuar masën e trafikut që mbulohet nga ato linja ajrore për shërbimet e miratuara dhe origjinën dhe destinacionin e këtij trafiku.

Neni 11 **Transferimi i fitimeve**

1. Secila palë kontraktuese i jep linjës së caktuar të palës tjetër kontraktuese të drejtën e transferimit të lirë të fitimeve tej shpenzimeve që nxirren në territorin e palës kontraktuese përkatëse. Këto transferita kryhen mbi bazën e normave zyrtare të këmbimit ose nëse nuk ka norma zyrtare të këmbimit, sipas normave mbizotëruese të tregut të këmbimit të huaj për pagesa përkatëse.

2. Nëse një palë kontraktuese cakton kufizime për transferimin e fitimeve tej shpenzimeve nga linja e caktuar e palës tjetër kontraktuese, kjo e fundit ka të drejtën të vendosë kufizime reciproke për linjën e caktuar të asaj palë kontraktuese.

Neni 12 **Siguria e aviacionit**

1. Në pajtim me të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare, palët kontraktuese riafirmojnë që detyrimi i tyre ndaj njëra-tjetrës për të mbrojtur sigurinë e aviacionit civil ndaj akteve të ndërhyrjeve të paligjshme përbën pjesë përbërëse të kësaj marrëveshjeje. Pa kufizuar të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare, palët kontraktuese veprojnë veçanërisht në pajtim me dispozitat e konventës për veprat penale dhe veprimeve të tjera të caktuara që kryhen në bordin e avionit, të nënshkruar në Tokio, më 14 shtator 1963, me konventën për ndalimin e konfiskimit të paligjshëm të avionit, të nënshkruar në Hagë, më 16 dhjetor 1970 dhe me konventën për ndalimin e veprimeve të paligjshme kundër sigurisë së aviacionit civil të nënshkruar në Montreal, më 23 shtator 1971 dhe me protokollin për ndalimin e veprimeve të paligjshme të dhunës në aeroportet që i shërbejnë aviacionit ndërkombëtar civil, të bërë në Montreal, më 24 shkurt 1988, dhe dispozitat e marrëveshjeve shumëpalëshe që bëhen detyruese për të dyja palët kontraktuese.

2. Palët kontraktuese i japin njëra-tjetrës, me kërkesë, të gjithë ndihmën e nevojshme për të parandaluar veprimet e konfiskimit të paligjshëm të avionit civil dhe veprimet e tjera të paligjshme ndaj sigurisë së këtyre avionëve, pasagjerëve dhe ekuipazhit, aeroporteve dhe shërbimeve të navigimit ajror, dhe çdo kërcënimi tjetër ndaj sigurisë së aviacionit civil.

3. Palët kontraktuese, në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, veprojnë në pajtim me dispozitat e sigurisë së aviacionit që janë vendosur nga organizata ndërkombëtare e aviacionit civil dhe janë caktuar si anekse të konventës për aviacionin ndërkombëtar civil, në masën që këto dispozita sigurie janë të zbatueshme për të dyja palët kontraktuese; ato kërkojnë që operatorët e avionëve të regjistrave të tyre ose operatorët e avionëve që kanë vendin kryesor të biznesit ose vendbanimin e përhershëm në territorin e tyre dhe operatorët e aeroporteve në territorin e tyre të veprojnë në pajtim me këto dispozita të sigurisë së aviacionit.

4. Secila palë kontraktuese bie dakord që këtyre operatorëve të avionëve mund t'u kërkohej të respektojnë dispozitat e sigurisë së aviacionit të përmendura në paragrafin 3 të mësipërm që kërkohej nga pala tjetër kontraktuese për hyrjen, largimin ose gjatë qëndrimit në territorin e asaj pale kontraktuese.

Secila palë kontraktuese garanton që të zbatohen masa të përshtatshme brenda territorit të saj për të mbrojtur avionin dhe për të inspektuar pasagjerët, ekuipazhin, artikujt që transportohen, bagazhet, mallrat dhe rezervat e avionit para dhe gjatë imbarkimit ose ngarkimit. Secila palë kontraktuese shqyrton pozitivisht çdo kërkesë nga pala tjetër kontraktuese për masa të veçanta dhe të arsyeshme të sigurisë për të trajtuar një rrezik të caktuar.

5. Nëse ndodh një incident ose kërcënim për një incident të një konfiskimi të paligjshëm të avionit civil ose veprim tjetër kundër sigurisë së këtij avioni pasagjerëve dhe ekuipazhit të tij, aeroporteve ose pajisjeve të navigimit ajror, palët kontraktuese ndihmojnë njëra-tjetrën duke lehtësuar komunikimin dhe me masa të tjera të përshtatshme të synuara për ndërprerjen e menjëhershme dhe të sigurt të këtij incidenti ose kërcënimi të tij.

6. Nëse një palë kontraktuese ka probleme në lidhje me dispozitat e këtij neni mbi sigurinë e aviacionit, autoritetet aeronautike të një pale kontraktuese mund të kërkojnë konsultime të menjëhershme me autoritetet aeronautike të palës tjetër kontraktuese.

Neni 13

Siguria e aviacionit

1. Secila palë kontraktuese mund të kërkojë konsultime në çdo kohë për sa u përket standardeve të sigurisë në çdo zonë në lidhje me ekuipazhin e fluturimit, avionin ose operimin e tyre të miratuara nga pala tjetër kontraktuese. Këto konsultime zhvillohen brenda tridhjetë (30) ditëve nga kërkesa.

2. Nëse pas këtyre konsultimeve, një palë kontraktuese konstaton se pala tjetër kontraktuese nuk mban dhe administron me efektivitet standardet e sigurisë në një zonë të tillë që të jenë të paktën sa standardet minimale të caktuara në atë kohë në pajtim me konventën, pala e parë kontraktuese njofton palën tjetër kontraktuese për këto konstatime dhe hapat e konsideruar të nevojshëm për të respektuar këto standarde minimale dhe që pala tjetër kontraktuese do të marrë masa të përshtatshme korrigjuese. Mosmarrja nga pala tjetër kontraktuese e masave të përshtatshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve ose një periudhe tjetër më të gjatë, për të cilën bihet dakord është shkak për zbatimin e nenit 5 të kësaj marrëveshjeje.

3. Pavarësisht detyrimeve të përmendura në nenin 33 të konventës, bihet dakord që çdo avion që operohet nga linja e një pale kontraktuese për shërbimet për në ose nga territori i palës tjetër kontraktuese, ndërsa është në territorin e palës tjetër kontraktuese, mund t'i nënshtrohet një verifikimi nga përfaqësuesit e autorizuar të palës tjetër kontraktuese, në bord dhe përreth avionit për të kontrolluar vlefshmërinë e dokumenteve të avionit dhe atyre të ekuipazhit të tij dhe gjendjen e



jashtme të avionit dhe pajisjeve të tij (në këtë nen quhet “inspektim në ndalesë”), me kusht që kjo të mos shkaktojë vonesë të paarsyeshme.

4. Nëse një inspektim i tillë në ndalesë ose disa inspektime të tilla në ndalesë shkaktojnë:

a) shqetësim serioz që një avion ose operimi i një avioni nuk përmbush standardet minimale të caktuara në atë moment në pajtim me konventën; ose

b) shqetësim serioz, që ka mungesë të ruajtjes dhe administrimit efektiv të standardeve të sigurisë të caktuara në atë kohë në pajtim me konventën, pala kontraktuese që kryen inspektimin, për qëllimet e nenit 33 të konventës, është e lirë të nxjerrë përfundimin që kërkesat në bazë të të cilave janë dhënë ose konsideruar të vlefshme certifikata ose licencat në lidhje me atë avion ose në lidhje me ekuipazhin e atij avioni ose kërkesat, sipas të cilave operon avioni, nuk janë të barabarta ose mbi standardet minimale të vendosura në pajtim me konventën.

5. Në rastin ku hyrja për qëllimet e ndërmarrjes së inspektimit në ndalesë të një avioni të operuar nga linja ose linjat e një pale kontraktuese në pajtim me paragrafin 3 të mësipërm, nuk lejohet nga përfaqësuesit e asaj linje ose linjave, pala tjetër kontraktuese është e lirë të nxjerrë përfundimin që lindin shqetësimet serioze të tipit të përmendur në paragrafin 4 të mësipërm dhe të nxjerrë përfundimet e përmendura në atë paragraf.

6. Secila palë kontraktuese rezervon të drejtën të pezullojë ose ndryshojë autorizimin e operimit të linjës së palës tjetër kontraktuese menjëherë në rastin kur pala e parë kontraktuese nxjerr përfundimin, si rezultat i një inspektimi në ndalesë, konsultimi ose tjetër, që veprimi i menjëhershëm është thelbësor për sigurinë e operimit të linjës.

7. Çdo veprim i një pale kontraktuese, në pajtim me paragrafin 2 ose 6 më sipër, ndërpritet menjëherë, sapo baza për marrjen e atij veprimi pushon së ekzistuari.

Neni 14

Pagesat e përdoruesit

Çdo pagesë që mund të caktohet ose lejohet të caktohet nga një palë kontraktuese për përdorimin e aeroportëve ose pajisjeve të navigimit ajror nga avioni i palës tjetër kontraktuese nuk është më e lartë se ato që do të paguheshin nga avioni vendas i përfshirë në shërbimet ajrore të planifikuara ndërkombëtare.

Neni 15

Zbatueshmëria e legjislacionit vendas

Ligjet dhe rregulloret e një pale kontraktuese në lidhje me lejimin ose largimin nga territori i pasagjerëve, ekuipazhit ose mallrave të avionit, si rregulloret në lidhje me hyrjen, lejen, emigrimin, pasaportat, doganën, monedhën, shëndetin dhe karantinën respektohen nga ose në emër të këtyre pasagjerëve, ekuipazhit ose mallrave gjatë hyrjes ose largimit, ose gjatë qëndrimit në territorin e palës kontraktuese.

1. Ligjet dhe rregulloret e një pale kontraktuese zbatohen në lidhje me pranimin ose largimin nga territori të avionit të angazhuar në navigimin ajror ndërkombëtar ose në lidhje me operimin dhe navigimin e këtij avioni të palës tjetër kontraktuese gjatë qëndrimit brenda territorit të saj.

2. Autoritetet përkatëse të palës tjetër kontraktuese kanë të drejtën pa vonesa të paarsyeshme të kontrollojnë avionin e palës tjetër kontraktuese menjëherë pas zbritjes ose para largimit dhe të inspektojnë certifikatën dhe dokumentet e tjera të parashikuara nga Konventa.

Neni 16
Aktivitetet tregtare

Secila palë kontraktuese lejon linjën e caktuar të palës tjetër kontraktuese të sjellë dhe të mbajë në territorin e palës tjetër kontraktuese punonjës dhe personel tjetër përgjegjës për administrimin, operacionet teknike dhe tregtare të aktiviteteve të tyre të shërbimeve ajrore në pajtim me rregullat dhe rregulloret e hyrjes, qëndrimit dhe punësimit të palës tjetër kontraktuese.

Neni 17
Konsultimi

1. Në frymën e bashkëpunimit të ngushtë, autoritetet aeronautike të palëve kontraktuese konsultojnë njëra-tjetrën herë pas here me qëllim sigurimin e zbatimit dhe respektimit të arsyeshëm të dispozitave të kësaj marrëveshjeje dhe grafikëve të bashkëlidhur dhe konsultohen nëse është e nevojshme për të parashikuar modifikimet e tyre.

2. Secila palë kontraktuese mund të kërkojë konsultimin me shkrim që fillon brenda një periudhe prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e marrjes së kërkesës, përveç kur palët kontraktuese bien dakord për zgjatjen e këtij afati.

Neni 18
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Nëse lind një mosmarrëveshje ndërmjet palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje, palët kontraktuese së pari përpiqen ta zgjidhin atë me bisedime.

2. Nëse palët kontraktuese nuk mund të arrijnë një zgjidhje me bisedime, ato mund të bien dakord të paraqesin mosmarrëveshjen për vendim para një personi ose organi; nëse ato nuk bien dakord, mosmarrëveshja, me kërkesë të një pale kontraktuese paraqitet për vendim te një gjykatë prej tre (3) arbitrash, ku një emërohet nga secila palë kontraktuese dhe i treti caktohet nga dy të emëruarit në këtë mënyrë. Secila prej palëve kontraktuese cakton një arbitër brenda një periudhe prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e marrjes nga njëra prej palëve kontraktuese prej tjetrës të një njoftimi nëpërmjet kanaleve diplomatike që kërkon gjykimin në arbitrazh të mosmarrëveshjes nga kjo gjykatë dhe arbitri i tretë emërohet brenda një periudhe tjetër prej gjashtëdhjetë (60) ditësh. Nëse një prej palëve kontraktuese nuk cakton një arbitër brenda afatit të caktuar, ose nëse arbitri i tretë nuk caktohet brenda afatit të caktuar, kryetari i këshillit të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, me kërkesë të një pale kontraktuese, mund të emërojë një arbitër ose arbitrat sipas rastit. Në këtë rast, arbitri i tretë është shtetas i një shteti të tretë dhe vepron si kryetar i gjykatës së arbitrazhit.

3. Secila prej palëve kontraktuese mbulon shpenzimet e arbitrit që ka caktuar, si dhe për përfaqësimin e saj në gjykimin në arbitrazh. Shpenzimet e kryetarit dhe çdo shpenzim tjetër mbulohet nga palët kontraktuese në pjesë të barabarta.

4. Pala kontraktuese respekton çdo vendim të dhënë në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 19
Ndryshimet

1. Nëse një palë kontraktuese e konsideron të dëshirueshme modifikimin e ndonjë dispozite të kësaj marrëveshjeje, këto ndryshime, nëse bihet dakord ndërmjet palëve kontraktuese dhe nëse është e nevojshme pas konsultimeve në pajtim me nenin 17 të kësaj marrëveshjeje, hyjnë në fuqi pasi konfirmohen pas shkëmbimit të notave nëpërmjet kanaleve diplomatike.



2. Nëse ndryshimi ka të bëjë me dispozitat e marrëveshjes të ndryshme nga ato të grafikëve të bashkëlidhur, ndryshimi miratohet nga secila palë kontraktuese në pajtim me procedurat e saj kushtetuese.

3. Nëse ndryshimi ka të bëjë vetëm me grafikët e bashkëlidhur, ai bihet dakord ndërmjet autoriteteve aeronautike të të dyja palëve kontraktuese.

Neni 20

Regjistrimi tek Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil

Kjo marrëveshje dhe çdo ndryshim pasues i saj regjistrohet tek Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil nga shteti ku kryhet nënshkrimi i marrëveshjes.

Neni 21

Njohja e certifikatave dhe licencave

1. Certifikatat e përshtatshmërisë për fluturim, certifikatat e kompetencës dhe licencat e lëshuara ose të deklaruara të vlefshme nga një palë kontraktuese dhe që vazhdojnë të jenë në fuqi, njihen si të vlefshme nga pala tjetër kontraktuese për qëllimin e operimit të shërbimeve të parashikuara nga kjo marrëveshje, me kusht që kërkesat sipas të cilave janë lëshuar ose deklaruar të vlefshme këto certifikata ose licenca, të jenë të barabarta ose mbi standardet minimale që janë caktuar ose mund të caktohen në pajtim me Konventën. Megjithatë, secila palë kontraktuese rezervon të drejtën të refuzojë njohjen për qëllimet e fluturimeve mbi territorin e vet, të certifikatave të kompetencës dhe licencave të dhëna shtetasve të saj ose që janë deklaruar të vlefshme për ta nga pala tjetër kontraktuese ose nga një shtet tjetër.

2. Nëse privilegjet ose kushtet e licencave ose certifikatave të përmendura në paragrafin 1 të mësipërm, të lëshuara nga autoritete aeronautike të një prej palëve kontraktuese një personi ose linje të caktuar në lidhje me një avion që operon shërbimet e miratuara në itineraret e caktuara, do të lejonin një ndryshim nga standardet e caktuara sipas Konventës, dhe ky ndryshim është depozituar tek Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil, autoritetet aeronautike të palës tjetër kontraktuese mund të kërkojnë konsultime në pajtim me nenin 17 të kësaj marrëveshjeje me autoritetet aeronautike të asaj pale kontraktuese, me qëllim bindjen që praktika në fjalë është e pranueshme për ta. Mosarritja e një marrëveshjeje të pranueshme përbën shkak për zbatimin e nenit 5 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 22

Përputhja me konventat shumëpalëshe

Nëse një konventë ose marrëveshje shumëpalëshe e përgjithshme e transportit ajror hyn në fuqi në lidhje me të dyja palët kontraktuese, kjo marrëveshje dhe anekset e saj konsiderohen të jenë ndryshuar përkatësisht.

Neni 23

Anekset

Anekset e kësaj marrëveshjeje konsiderohen të jenë pjesë e marrëveshjes dhe të gjitha referencat ndaj saj përfshijnë referencën tek anekset, përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe.

Neni 24
Përfundimi i marrëveshjes

Secila palë kontraktuese në çdo kohë mund të njoftojë palën tjetër kontraktuese për vendimin e saj për të prishur këtë marrëveshje; ky njoftim i komunikohet njëkohësisht, Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil. Në këtë rast, marrëveshja përfundohet dymbëdhjetë 12 muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga pala tjetër kontraktuese, përveç kur njoftimi për prishjen tërhiqet me marrëveshje para skadimit të këtij afati. Në mungesë të njohjes së marrjes nga pala tjetër kontraktuese, njoftimi konsiderohet të jetë marrë katërbëdhjetë (14) ditë pas marrjes së njoftimit nga organizata ndërkombëtare e aviacionit civil.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje miratohet në pajtim me kërkesat kushtetuese në vendin e secilës palë kontraktuese dhe hyn në fuqi ditën e shkëmbimit të notave diplomatike nga palët kontraktuese.

Në dëshmi sa më sipër, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 18 tetor 2011, në dy kopje në gjuhët shqipe, arabe dhe angleze ku të gjitha tekstet janë njëloj autotentike.

Në rast mospërputhjeje në interpretim, ka përparësi teksti në gjuhën angleze.

ANEKS

Grafiku i itinerarit 1

1. Itineraret që do të operohen nga linja e caktuar nga Republika e Shqipërisë

Nga	Pikë e ndërmjetme	Për në	Pikat përtej
1	2	3	4
Tirana	Çdo pikë	Doha	Çdo pikë
Doha	Çdo pikë	Tirana	Çdo pikë

2. Linja e caktuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në të gjitha ose secilin prej fluturimeve, mund të mos ulet në ndonjë prej pikave të kolonës 2 dhe 4 më sipër, me kusht që shërbimet e miratuara për këto itinerare të fillojnë në një pikë në kolonën 1.

Grafiku i itinerarit 2

1. Itineraret që do të operohen nga linja e caktuar nga shteti i Katarit

Nga	Pikë e ndërmjetme	Për në	Pikat përtej
1	2	3	4
Doha	Çdo pikë	Tirana	Çdo pikë
Tirana	Çdo pikë	Doha	Çdo pikë

2. Linja e caktuar nga Qeveria e shtetit të Katarit, në të gjitha ose secilin prej fluturimeve, mund të mos ulet në ndonjë prej pikave të kolonës 2 dhe 4 më sipër, me kusht që shërbimet e miratuara për këto itinerare të fillojnë në një pikë në kolonën 1.



VENDIM
Nr. 17/2012

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ELVIS ÇEFA ANËTAR TË KËSHILLIT TË LARTË
TË DREJTËSISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 147 të Kushtetutës, të nenit 4 pikat 2 dhe 7 të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Elvis Çefa zgjidhet anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 12.4.2012

VENDIM
Nr. 18/2012

**PËR NJOFTIMIN E KRIJIMIT TË VAKANCËS, PËR SHKAK TË DORËHEQJES NGA
MANDATI I DEPUTETIT GJON HILL BARDHI DHE PLOTËSIMIN E DETYRIMEVE
DHE TË PROCEDURËS LIGJORE NGA KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR PËR
REFORMËN ZGJEDHORE PËR KANDIDATËT E LISTAVE SHUMEMËRORE TË
SUBJEKTEVE ZGJEDHORE, PAS PËRFUNDIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1 të Rregullores së Kuvendit, të nenit 164 pika 1 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, i cili mbështetet në premisat e asnjësisë në çështjet e debatit të ngritur rreth kësaj çështjeje,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Të njoftojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvend, për shkak të dorëheqjes nga mandati i deputetit Gjon Hill Bardhi.
- II. Rasti i zëvendësimit të këtij mandati, diskutimet juridike të zhvilluara për të dhe kompleksiteti i situatës së veçantë juridike të çështjes të merren në shqyrtim nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 141, datë

17.11.2011, me qëllim saktësimin dhe plotësimin e detyrimeve dhe të procedurës ligjore që duhet të ndiqet për kandidatët e listave shumemërore të subjekteve zgjedhore, pas përfundimit të zgjedhjeve për Kuvendin.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 12.4.2012

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP), PËR VITIN 2011

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke e konsideruar shumë të rëndësishëm rolin e AKEP-it në mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, si një treg me rritje të vazhdueshme dhe me një konkurrencë gjithnjë e më të shtuar;

- Duke vlerësuar punën voluminoze dhe profesionale të AKEP-it në përgatitjen e analizave të tregjeve për telefoninë fikse, telefoninë e lëvizshme dhe të linjave me qira;

- Duke vlerësuar punën e AKEP-it në përmirësimin e legjislacionit rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare;

- Duke vlerësuar punën e AKEP-it për përmirësimin e sistemeve informatike dhe implementimin e shërbimeve *on-line*;

Konstaton se AKEP-i për vitin 2011:

- Ka ofruar dhe ka dhënë autorizimin individual për përdorimin e frekuencave për ofrimin e shërbimeve të standardit 3G;

- Ka bërë të mundur sigurimin e ofrimit të portabilitetit të numrit;

- Ka punuar për ndryshime cilësore dhe reduktimin e tarifave të aksesit *broadband* në internet;

- Ka miraturar analizën finale të tregjeve me shumicë të shërbimeve të aksesit në rrjete fikse dhe *broadband*, e cila përfshin tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike nga vendndodhje fikse dhe tregun me shumicë të aksesit *broadband*;

- Ka punuar për realizimin e analizës së tregjeve me shumicë të terminimit të mesazheve SMS në rrjetet e telefonisë së lëvizshme, pavarësisht se ky treg nuk është pjesë e listës së tregjeve të rekomandimeve të KE-së apo e rregullores së Analizës së Tregut;

- Ka punuar për përgatitjen e dokumentit RUO, si një dokument bazë për përcaktimin e marrëdhënieve midis operatorëve për implementimin e hapjes së qarkut lokal;

- Ka administruar me efektivitet spektrin e frekuencave;

- Ka bërë një punë të mirë në lidhje me mbikëqyrjen e tarifave rekomanduese dhe marrëveshjeve të interkoneksionit dhe aksesit, si dhe në vlerësimin e ofertave referencë të interkoneksionit të operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg;

- Ka realizuar dhe ka miraturar metodën e orientimit të tarifave në kosto (BU-LRAIC) për rregullimin me reduktim të përshkallëzuar të tarifave të terminimit dhe origjinimit në rrjetet e telefonisë së lëvizshme, sipas kësaj metode;



- Nuk ka bërë një monitorim më të hollësishëm lidhur me ofrimin e shpejtësisë së internetit nga operatorët, e cila shpesh nuk arrin atë të reklamuar nga këta operatorë dhe nuk i përgjigjet asaj që realisht i shkon pajtimtarëve;

- Nuk ka bërë një analizë më të plotë dhe të detajuar për tregun postar;

- Nuk ka bërë një analizë më shteruese lidhur me penetrimin e ulët të telefonisë fikse, në raport me telefoninë e lëvizshme, për të orientuar operatorët drejt strategjive të reja për përhapjen në mënyrë më masive të telefonisë fikse;

- Ka punuar, por nuk ka përmbushur akoma implementimin e shërbimit universal.

Kërkon nga AKEP-i për vitin 2012:

- Të angazhohet në forcimin e mëtejshëm të pozitave të tij për mbikëqyrjen me transparencë dhe profesionalizëm të mbarëvajtjes së tregut të komunikimeve elektronike dhe postare;

- Të angazhohet në një mbikëqyrje më të fortë të marrëdhënies mes operatorëve, që operojnë në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare dhe konsumatorit, duke kërkuar nga operatorët që të jenë sa më transparentë dhe korrektë në shërbimet që i ofrojnë atij, duke miratuar dhe ndjekur zbatimin e kuadrit rregullator për publikimin e tarifave;

- Të vazhdojë të angazhohet në uljen e mëtejshme të tarifave të shërbimeve të ofruara në tregun e komunikimeve elektronike;

- Të vazhdojë të angazhohet në menaxhimin me efektivitet të frekuencave 3G;

- Të angazhohet në zbatimin e politikave nxitëse për një penetrim më të madh të telefonisë fikse dhe të nxisë konkurrencën në këtë sektor, duke krijuar një mjedis tërheqës për rritjen e investimeve në linjat fundore të abonentëve;

- Të angazhohet në hartimin e një kuadri të plotë rregullator për funksionimin e tregut postar;

- Të angazhohet në përafrimin e kuadrit rregullator me atë të Bashkimit Europian;

- Të angazhohet në përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në raport-progreset e BE-së për Shqipërinë;

- Të angazhohet në implementimin e fazave të mëtejshme për tarifat e terminimit të mesazheve SMS në rrjetet e telefonisë së lëvizshme;

- Të vazhdojë të angazhohet në implementimin e shërbimit universal, si e vetmja mundësi për ofrimin e shërbimeve bazë edhe në ato zona ku këto shërbime mungojnë apo ofrohen në mënyrë të pamjaftueshme.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

29 mars 2012

VENDIM

Nr. 167, datë 29.2.2012

PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM, 2013-2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2013-2015, sipas lidhjes nr. 1 "Tavanet e ministrive dhe institucioneve buxhetore" që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Emertimi i institucioneve buxhetore, në milion Lekë	viti 2013			viti 2014			viti 2015			Totali
	600-601 Paga-Sipos	602-606 Tijera Korane	230-232 Investim/ brendore	600-601 Paga-Sipos	602-606 Tijera Korane	230-232 Investim/ brendore	600-601 Paga-Sipos	602-606 Tijera Korane	230-232 Investim/ brendore	
Emertimi i institucioneve buxhetore										
1) Presidencia	92	55	10	157	95	10	157	95	10	166
2) Kuvendi	307	320	100	927	525	375	906	544	333	927
3) Këshilli i Ministrave	177	225	20	422	163	20	433	190	234	444
4) Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës	803	282	300	2,368	832	288	2,420	863	294	2,437
5) Ministria e Bujqësisë, Ujëvarëve dhe Mbrojtjes së Kopsit	1,765	2,251	1,800	7,310	1,870	2,341	8,071	1,957	2,388	2,000
6) Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikimit	970	2,953	6,462	44,068	10,500	5,090	42,224	11,088	3,147	9,000
7) Ministria e Francës	3,329	10,900	700	6,868	3,449	1,112	7,161	3,578	1,134	750
8) Ministria e Kulturës, Rreze dhe Sporteve	28,200	7,144	2,000	39,151	29,292	7,429	41,541	30,051	7,978	3,000
9) Ministria e Kulturës, Rreze dhe Sporteve	954	565	340	1,679	980	597	1,885	1,028	609	330
10) Ministria e Shëndetësisë	2,443	1,546	1,800	30,461	2,531	1,600	31,663	2,658	1,640	1,400
11) Ministria e Punëve të Jashtme	3,070	849	400	5,094	4,009	869	5,179	4,157	883	550
12) Ministria e Punëve të Jashtme	883	1,224	100	2,207	915	1,248	2,263	948	1,273	100
13) Ministria e Brendshme	11,813	3,322	900	16,155	12,238	3,308	16,836	12,851	3,455	850
14) Ministria e Mbrojtjes	7,223	5,441	3,100	21,279	7,443	5,477	20,061	7,700	5,944	2,800
15) Sherbimi Informativ Shqiptar	894	272	80	1,338	1,019	277	1,377	1,057	283	85
16) Sherbimi Informativ Shqiptar	0	352	50	402	0	358	409	0	366	50
17) Dëgjuesia e Radio Televizionit	130	35	0	173	135	36	178	140	37	8
18) Dëgjuesia e Radio Televizionit	33	48	1	82	35	49	85	36	50	1
19) Akademia e Shkencave	216	47	0	268	72	0	275	73	0	2
20) Akademia e Shkencave	1,130	21,256	140	57,337	1,171	21,970	60,591	1,214	22,879	140
21) Ministria e Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shërbimeve të Bara	930	224	300	1,374	964	278	1,612	988	233	300
22) Ministria e Mbrojtjes, Dytëve dhe Administrimit të Ujërave	983	271	140	1,394	1,018	278	1,434	1,056	282	145
23) Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	1,377	282	190	1,849	1,427	287	1,994	1,479	293	210
24) Gjykatat Kushtetuese	75	25	2	102	78	15	108	81	26	2
25) Agjencia Telegrafike Shqiptare	76	14	2	92	79	15	95	84	15	2
26) Partia Politike	0	200	0	200	0	200	200	0	204	0
27) Shërbimi Shërbimes	311	140	10	461	276	14	432	268	14	10
28) Shkolla e Magistraturës	26	28	2	58	29	29	60	31	29	2
29) Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	0	900	900	0	0	900	0	0	650
30) Zyra e Komiteteve të Rrëmbësive	9	93	2	104	10	2	107	11	97	2
31) Zyra e Komiteteve të Rrëmbësive	59	23	4	86	61	24	89	65	24	4
32) Bankat dhe Institucione të Financës	61	13	2	83	70	14	86	73	14	2
33) Komisioni i Shërbimit Civil	33	9	2	44	35	10	47	39	10	2
34) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	74	620	3	697	76	21	704	79	621	3
35) Komisioni i Lirisë Komerciale dhe Dëgjuesisë së Pasurive	62	24	4	90	64	7	93	67	25	4
36) Komisioni i Konkurrencës	46	9	5	62	50	9	64	52	9	5
37) Komisioni i Hiegjimit	82	48	15	145	85	19	149	88	50	15
38) Komisioni Komercial Konkurrencial	0	5	2	5	0	2	5	0	2	0
39) Komisioni i Punëve	19	5	2	26	20	5	27	21	5	2
40) Komisioni i Lirisë Komerciale dhe Dëgjuesisë së Pasurive	190	289	160	938	197	268	917	204	255	170
41) Komisioni për shërbime civile	14	60	2	86	15	8	98	16	8	2
42) Komisioni për Mbrojtjen e Detyrës Personale	34	10	2	46	36	10	46	37	10	2
43) Komisioni për Mbrojtjen nga Dëgjuesia	27	7	2	37	29	7	37	29	7	2
44) Komisioni i Shërbimit të Komunitetit	17	11	1	35	18	1	34	20	12	1



VENDIM

Nr. 181, datë 13.3.2012

PËR TRANSFERIMIN E INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT NË PRONËSI TË KOMUNËS BUSHAT, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1157, DATË 25.11.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË BORDEVE TË KULLIMIT, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 2.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 9 të ligjit nr. 8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (Bordi i Kullimit, Shkodër), në pronësi të komunës Bushat, Shkodër, pa ndryshuar destinacionin, sipas listës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të Bordit të Kullimit Shkodër, për komunën Bushat, e përcaktuar me vendimin nr. 1157, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me listën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i transferohen në pronësi komunës Bushat, që i bashkëlidhet vendimit nr. 68, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave, i shtohen pronat sipas listës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, komuna Bushat është përgjegjëse për operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe sigurinë e infrastrukturës ujitëse e kulluese të transferuar, për të realizuar ujitjen dhe kullimin në këtë komunë sipas parametrave teknikë të projektit dhe legjislacionit në fuqi.
5. Çdo projektzbatim i hartuar nga komuna Bushat, që lidhet me rehabilitimin / rikonstrukcionin e objekteve të infrastrukturës ujitëse e kulluese sipas listës nr. 1, para zbatimit, duhet të miratohet nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
6. Bordi i Kullimit, Shkodër t’i dorëzojë komunës Bushat të gjithë dokumentacionin teknik përkatës për infrastrukturën e transferuar.
7. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme dhe Komuna Bushat, të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lista Nr. 1 (Sipas Formularit per Inventarizimin e Pronave te Paluajtshme Shteterore)

Nr. Rend	A		B			C				
	Zona Kadastr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emeritesa e Prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m ²	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			Sistemi i Ujites dhe Kullimit	Sek. Shkoder	Qarku SHKODER					
			Komuna Bushat.							
10233	1329		Stacion Pompimi	Truali + ndertese	Bushat	23 5/23.5objek	Ujite	M B U M K.	Bordi kullimit	Jofunksional.
10235	"		K. II ujites stacioni Bushat	"	"	3000	"	"	"	Jofunksional.
10236	"		Kanal i dyte Ujites	"	"	5600	"	"	"	"
10237	"	K.K.87	Kanal i dyte Kullues	Ura tombino etj	"	28000	Kullim	"	"	"
10239	"		Kanal i pare Kullues	"	"	20000	"	"	"	"
10240	"	K.K.85,86	Kanal i dyte Kullues	"	"	32000	"	"	"	"
10241	"	K.K.87,88	Kanal i dyte Kullues	"	"	41600	"	"	"	"
10242	"		Kanal i dyte Kullues	"	"	44000	"	"	"	"
10244	"	K U	Kanal i dyte Ujites	"	"	3000	"	"	"	Jofunksional.
10245	"		Stacion Pompimi	Truali + ndertese	"	23 5/23.5objek	Ujite	"	"	Jofunksional.
10246	2236		Ncertes trangu argjin.	Truali + ndertese	Kosmaç	46/46 Objekt "	Mbrojte	M B U M K.	Bordi kullimit	E Zbtuar.
10249	"		Kanal i pare Ujites	"	"	20000	"	"	"	"
10250	"	K.U.2,...	Kanal i dyte Ujites	"	"	95700	"	"	"	"
10253	"	K.U.1,2,...	Kanal i dyte Ujites	"	"	32000	"	"	"	Jofunksional.
10255	"	K.K.2	Kanal i dyte Kullues	Ura tombino etj	"	22400	Kullim	"	"	Jofunksional.
10256	"	K.U.21	Kanal i dyte Ujites	Priza barazhe etj	"	8000	Ujite	"	"	Jofunksional.
10257	3205	K.K.2	Kanal i pare Kullues	Ura tombino etj	Ranxë	45000	Kullim	"	"	Jofunksional.
10258	"	K.K.11,...	Kanal i dyte Kullues	"	"	54400	Kullim	"	"	"
10259	"	K.U.25,...	Kanal i dyte Ujites	Priza barazhe etj	"	17600	Ujite	"	"	"
10260	2566	K.K.K	Kanal i pare Kullues	Ura tombino etj	Mali i Jushtit	96000	Kullim	"	"	"
10261	"	K.U.25	Kanal i dyte Kullues	"	"	24000	"	"	"	"
10262	2644	K.K.K2	Kanal i pare Kullues	Ura tombino etj	Melguste	30000	Kullim	"	"	"
10263	"	K.U.22,...	Kanal i dyte Ujites	Priza barazhe etj	"	68100	Ujite	"	"	"



Lista Nr. 2 (Sipas Formularit për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore)

Nr. Rendi	A			B				C			
	Zona Kadastr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja / Shtirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e m ²	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
			Sistemi i Ujites dhe Kullimit Komuna Bushat.	Sek. Shkodër	Qarku SHKODËR						
10234	"	K.U.P.121	Kanal i pare Ujites	Priza barazhe etj	"	28000	"	"	"		
10238	3389	K.K.K	K. I kullies Drini vjeter	"	Shkjesë	105000	"	"	"		
10243	"	K.U.P.121	Kanal i pare Ujites	Priza barazhe etj	"	21000	Ujite	"	"		
10247	"		Argjinature mbrojtese	Argj. Me dhe & zhavorr	"	37640	Mbrojtje nga Drini	"	"		
10248	"	K.U.P.121	Kanal i pare Ujites	Priza barazhe etj	"	15000	Ujite	"	"		
10251	3506		Argjinature mbrojtese	Argj. Me dhe & zhavorr	Stajkë	19200	Mbrojtje nga Drini	"	"		
10252	"	KUP.121	Kanal i pare Ujites	Priza barazhe etj	"	39000	Ujite	"	"		
10254	1057		Argjinature mbrojtese	Argj. Me dhe & zhavorr	Ashtë	4800	Mbrojtje nga Drini	"	"		

VENDIM
Nr. 184, datë 13.3.2012

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 405, DATË 8.1.1996
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ADMINISTRIMIN E RRJETIT RRUGOR
KOMBËTAR DHE RRJETIT RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, rrjetit rrugor kombëtar i shtohen segmentet rrugore sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Në tabelën “Inventari i rrugëve rurale, rajonale e komunale”, pika 4/1, hiqen segmentet rrugore sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
 3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Brendshme dhe qarqet për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



LIDHJA NR. 1
SEGMENTET RRUGORE QË DO TË KALOJNË NGA INVENTARI I RRUGËVE RAJONALE RURALE NË INVENTARIN E RRUGËVE
NACIONALE

Nr.	Qarku	Emri i nënprojektit	Emërtimi i pikës së fillimit	Emërtimi i pikës së mbarimit	Gjatësia (km)	Koordinatat e pikës së fillimit	Koordinatat e pikës së fundit
1	Fier	Strum-Qafë Marinzë	Strum	Qafë Marinzë	12.6	N 40° 43' 10" E 19° 39' 47"	N 40° 45' 03" E 19° 44' 35"
2	Fier	Sheq-Marinzë	Kryqëzimi Sheq	Rruga Nationale Fier-Berat	15.7	N 40° 43' 30" E 19° 34' 27"	N 41° 43' 59" E 19° 39' 58"
3	Fier	Ballsh- Aranitas	Ballsh	Aranitas	6.3	N 40° 36' 13" E 19° 44' 47"	N 40° 35' 49" E 19° 48' 24"
4	Berat	Ura e Gorricës-Mbreshtan	Ura e Goricës	Fshat Mbreshtan	7.8	N 40° 42' 09" E 19° 56' 40"	N 40° 42' 55" E 19° 52' 31"
5	Durrës	Shijak-Maminas	Shijak	Maminas	5	N 41° 20' 55" E 19° 33' 53"	N 41° 32' 15" E 19° 36' 17"
6	Elbasan	Belsh-Fierzë	Belsh	Degëzim Rruga Fierzë	9.2	N 41° 30' 33" E 20° 28' 55"	N 40° 58' 46" E 19° 53' 22"
7	Gjirokastër	Valare-Erind	Valare	Erind	6	N 40° 07' 32" E 20° 08' 09"	N 40° 09' 21" E 20° 09' 55"
8	Korçë	Koritë-Liqenas	Koritë	Liqenas	9.1	N 40° 43' 21" E 20° 52' 46"	N 40° 43' 21" E 20° 52' 44"
9	Korçë	Lapidar-Koritë	Kryqëzim Podgorie (Lapidari)	Koritë	10.5	N 40° 48' 40" E 20° 47' 54"	N 40° 43' 21" E 20° 52' 46"
10	Tiranë	Ura e Farkës-Qendër Fshat	Ura e Farkës	Qendër Fshat	6.5	N 41° 16' 11" E 19° 50' 26"	N 41° 14' 21" E 19° 48' 00"
11	Vlorë	Xarrë-Fshat Pllakë	Xarrë	Fshati Pllakë	10.9	N 39° 43' 23" E 20° 04' 12"	N 39° 48' 33" E 20° 04' 53"
12	Vlorë	Pllakë-Cukë	Pllakë	Cukë	11.5	N 39° 52' 29" E 20° 01' 47"	N 39° 50' 51" E 20° 01' 32"
13	Berat	Mbreshtan-Sinje	Fshat Mbreshtan	Fshat Sinje	10.1	N 40° 42' 55" E 19° 52' 31"	N 40° 38' 46" E 19° 52' 13"
14	Dibër	Kuben-Përroi i Kapsit	Kuben	Përroi i Kapsit	9.8	N 41° 41' 46" E 20° 23' 54"	N 41° 45' 32" E 20° 23' 32"
15	Dibër	Përroi i Kapsit -Vleshe	Përroi i Kapsit	Vleshe	12	N 41° 45' 32" E 20° 23' 32"	N 41° 48' 45" E 20° 25' 44"
16	Dibër	Vleshe-Vasie	Vleshe	Vasie	12.5	N 41° 48' 45" E 20° 25' 44"	N 41° 51' 45" E 20° 25' 55"

17	Dibër	Ura Qytetit-Zerqan	Ura e Qytetit	Zerqan	6.3	N 40° 53' 59" E 19° 48' 59"	N 41° 30' 13" E 20° 21' 17"
18	Durrës	Bubq-Ishëm	Bubq	Ishëm	13.4	N 41° 27' 56" E 19° 41' 21"	N 41° 32' 27" E 19° 35' 25"
19	Elbasan	Urake-Golik			8.6	N 41° 05' 12" E 20° 35' 01"	N 41° 02' 24" E 20° 31' 07"
20	Elbasan	Fierzë-Kosovë-Kosovë e vogël	Degëzim Rruga Fierzë	Kosovë e Vogël	6.5	N 40° 58' 46" E 19° 53' 22"	N 40° 53' 53" E 19° 46' 58"
21	Fier	Rrugë Nacionale-Bylis	Rrugë Nacionale	Parku Kombëtar Bylis	5.8	N 40° 36' 12" E 19° 44' 10"	N 40° 33' 48" E 19° 44' 30"
22	Gjirokastrë	Erind-Çajup	Erind	Çajup	14.2	N 40° 09' 21" E 20° 09' 55"	N 40° 11' 04" E 20° 11' 00"
23	Kukës	Domaj -Ura e Lapajve	Domaj	Ura e Lapajve	11.5	N 41° 58' 01" E 20° 24' 00"	N 41° 53' 42" E 20° 25' 00"
24	Kukës	Ura e Lapajve-Bushtricë	Ura e Lapajve	Bushtricë	7.2	N 41° 53' 42" E 20° 25' 00"	N 41° 54' 40" E 20° 24' 06"
25	Lezhe	Lezhë - Kallmet	Lezhë	Kallmet	7.2	N 41° 47' 14" E 19° 38' 46"	N 41° 52' 25" E 19° 41' 55"
26	Lezhe	Kallmet-Nenshat	Kallmet	Nenshat	8.75	N 41° 52' 25" E 19° 41' 55"	N 41° 55' 35" E 19° 39' 30"
27	Shkodër	Vau i Dejës-Nenshat	Vau i Dejës	Nenshat	11.8	N 42° 00' 33" E 19° 38' 55"	N 41° 55' 35" E 19° 39' 31"
28	Tiranë	Rrugë Nacionale-Prezë	Rruga Nacionale	Kala Prezë	3.2	N 41° 24' 29" E 19° 40' 42"	N 41° 25' 46" E 19° 40' 21"
29	Tiranë	Qendër - Mustafa Kocaj	Qendër Fshat	Mustafa Kocaj	8	N 41° 14' 21" E 19° 48' 00"	N 41° 10' 52" E 19° 50' 01"
30	Vlorë	Sevaster-Kalivaç	Sevaster	Kalivaç	9.4	N 40° 23' 49" E 19° 43' 54"	N 40° 23' 59" E 19° 47' 40"
31	Durrës	Thumanë-Laç	Thumanë	Laç	10.5	N 41° 32' 50" E 19° 40' 56"	N 41° 37' 09" E 19° 42' 38"
32	Dibër	Burrel-Komsi	Unaza Burrel	Dalje e Komunës Komsi	5.7	N 41° 36' 11" E 20° 00' 13"	N 41° 52' 52" E 19° 57' 16"
33	Elbasan	Gramsh-Kodovjat	Rrugë Nacionale	Kodovjat	12.7	N 40° 51' 50" E 20° 11' 47"	N 40° 48' 09" E 20° 15' 18"
34	Berat	Kutalli-Gorician-Hinke	Kutalli	Hinke	8.2	N 40° 46' 55" E 19° 47' 05"	N 40° 49' 11" E 19° 46' 49"
35	Kukës	Kukës-Shishtavec	Lot. II	Lot. II	6	N 45° 04' 56" E 20° 29' 40"	N 42° 02' 57" E 20° 31' 42"
36	Shkodër	Ura Mesit-Prekal	Ura e Mesit	Prekal	15.4	N 42° 07' 42" E 19° 35' 09"	N 42° 10' 47" E 19° 43' 14"



37	Shkodër	Gjadër-Mnel	Ura e Gjadrit	Qendër Komuna Vig Mnel	7.2	N 41° 58' 48" E 19° 38' 43"	N 42° 58' 14" E 19° 41' 55"
38	Fier	Metohasimi-Kafaraj	Metoasim	K/Frakull- Kashishtë	8.5	N 40° 41' 11" E 19° 33' 11"	N 40° 37' 55" E 19° 30' 48"
39	Tiranë	Q. Priskë - Shkallë - Shëngjergj	Q. Priskë	Shëngjergj	17.1	N 41° 19' 37" E 19° 57' 30"	N 41° 19' 44" E 20° 05' 28"
40	Tiranë	Bërxull-Domje	Bërxull	Domje	5.3	N 41° 22' 51" E 19° 42' 47"	N 41° 22' 41" E 19° 41' 49"
41	Durrës	Shijak-Gjepalaj	Shijak	K/Komuna Gjepalaj	6.3	N 41° 20' 32" E 19° 34' 17"	N 41° 18' 28" E 19° 35' 43"
42	Durrës	Shënavlash-K/Fllakë-Katund i Ri	Vrinë	Katundi i Ri	9.3	N 41° 23' 07" E 19° 29' 45"	N 41° 23' 13" E 19° 30' 13"
43	Tiranë	Rrugë Nacionale-Vishaj	Rrugë Nacionale	Qendër Fshat	8.9	N 41° 15' 41" E 19° 48' 48"	N 41° 17' 49" E 19° 44' 04"
44	Fier	Rrugë Nacionale-Grabian	Rrugë Nacionale	Grabian	4.3	N 40° 59' 02" E 19° 39' 59"	N 40° 59' 28" E 19° 37' 01"

VENDIM
Nr. 187, datë 6.3.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “CANGONJ” DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3 e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Cangonj” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2% të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “FAVINA 1” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Cangonj”, të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 188, datë 6.3.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “MALIND” DHE MIRATIMIN E BONUSIT,
NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3 e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Malind” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2% të pikëve, për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë “Al-Can Hidropower Energy” sh.p.k.



3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Malind”, të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 189, datë 13.3.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 419, DATË 14.4.2011, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E AFATEVE DHE TË SKEMËS SË SHPËRNDARJES
SË FONDEVE TË DËMSPËRBLIMIT PËR ISH-TË DËNUARIT POLITIKË TË
REGJIMIT KOMUNIST”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 6, të vendimit nr. 419, datë 14.4.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Afati i shpërndarjes së kështit të dytë fillon më 26 mars 2012.

b) Në shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, dhe “e” hiqen fjalët “... për të gjitha subjektet përfituese ...”

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 190, datë 13.3.2012

**PËR KODIN E HARTIMIT, ADOPTIMIT, MIRATIMIT DHE ZBATIMIT
TË STANDARDEVE***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr. 9870, datë 4.2.2008 “Për standardizimin”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Kodit të Hartimit, Adoptimit, Miratimit dhe Zbatimit të Standardeve, sipas tekstit bashkëlidhur.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) për zbatimin e këtij vendimi.
 3. Vendimi nr. 242, datë 28.5.1999 “Për miratimin e Kodit të Përgatitjes, Adoptimit, Miratimit dhe Zbatimit të Standardeve”, shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KODI
I HARTIMIT, ADOPTIMIT, MIRATIMIT DHE ZBATIMIT TË STANDARDEVE

1. Termat e përdorur për qëllime të këtij kodi kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e termave të dhënë në ligjin nr. 9870, datë 4.2.2008 “Për standardizimin”.
2. DPS-ja gjatë hartimit të standardeve, trajton, me të njëjtën përparësi, produktet e vendit dhe produktet e njëjta të çdo vendi anëtar të OBT-së dhe të çdo vendi tjetër.
3. DPS-ja siguron se standardet që hartohen, adoptohen, miratohen dhe zbatohen të mos krijojnë pengesa të panevojshme për tregtinë ndërkombëtare.
4. Në rastet kur ekzistojnë standarde ndërkombëtare, adoptimi i të cilave është i domosdoshëm, DPS-ja i përdor ato ose pjesë të rëndësishme të tyre, si bazë për standardet që harton. Përrjashtohen nga ky përdorim rastet kur standardet ndërkombëtare ose pjesë të tyre, janë jo efektive ose të papërshtatshme, për shkak të nivelit të pamjaftueshëm të mbrojtjes, faktorëve bazë klimaterikë apo gjeografikë ose problemeve me bazë teknologjike.
5. DPS-ja sipas mundësive, merr pjesë në procesin e hartimit dhe miratimit, nga organizatat përkatëse ndërkombëtare të standardizimit, të atyre standardeve, për të cilat ajo gjykon se janë në proces ose do të adoptohen si standarde kombëtare.
6. DPS-ja eviton punën paralele dhe/ose mbivendosjen me punën e organeve përkatëse rajonale ose ndërkombëtare të standardizimit. Ajo merr të gjitha masat për të arritur konsensusin kombëtar për standardet që harton.
7. DPS-ja harton standardet duke u mbështetur në vetitë e produkteve dhe jo në anën përshkrimore të tyre.

*Aneksi i marrëveshjes mbi barrierat teknike në tregti i Organizatës Botërore të Tregtisë, ratifikuar me ligjin nr. 8648, datë 28.7.2000 “Për ratifikimin e “Protokollit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen e Marrakeshit, që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë””.



8. Çdo 6 muaj DPS-ja boton programin e punës, i cili përmban emrin dhe adresën e saj, standardet që aktualisht po përgatiten dhe listën e standardeve që ka adoptuar në periudhën e mëparshme.

9. Standardi konsiderohet në përgatitje e sipër që nga momenti që është marrë vendimi për hartimin e tij dhe derisa të miratohet. Titujt e projektstandardeve, duhet të jepen në anglisht ose frëngjisht, sipas kërkesës. Ekzistenca e programit të punës njoftohet në një botim zyrtar të DPS-së. Programi i punës duhet të tregojë për çdo standard, në përputhje me rregullat e ISONET, klasifikimin përkatës, nivelin e punës për hartimin e tij, referencat e çdo standardi ndërkombëtar të marrë për bazë dhe mënyrën se si mund të kërkohet nga të interesuarit. Ky program, sapo të botohet apo publikohet në faqen zyrtare të internetit, njoftohet në Qendrën e Informacionit të ISO/IEC në Gjenevë. Njoftimi përmban emrin dhe adresën e DPS-së, botimin ose linkun ku programi ka dalë, periudhën së cilës i përket, çmimin nëse ka dhe mënyra se si mund të sigurohet.

10. Përpara adoptimit të një standardi, DPS-ja lejon një periudhë të paktën 60-ditore për komente në lidhje me projektstandardin nga palët e interesuara në territorin e një vendi anëtar të OBT-së. Kjo periudhë mund të shkurtohet në rastet kur dalin probleme urgjente që lidhen me sigurinë, shëndetin ose mjedisin. Periudha e komenteve fillon që në momentin kur programi i punës së standardeve publikohet në një nga botimet zyrtare të DPS-së, sipas paragrafit 9 më sipër. Njoftimi përfshin edhe devijimet përkatëse nga standardet ndërkombëtare, nëse ka të tilla.

11. Me kërkesën e çdo pale të interesuar brenda territorit të një vendi anëtar të OBT-së, DPS-ja i jep menjëherë ose merr masa për t'iu dhënë një kopje të projektstandardit, i cili është lënë për komente. Çdo pagesë për këtë shërbim është e njëjtë si për subjektet e vendit, ashtu edhe për ato të huaja, me përjashtim të kostos reale të dërgimit.

12. Gjatë përpunimit të mëtejshëm të standardit, DPS-ja merr parasysh komentet që janë bërë gjatë periudhës së caktuar për këtë qëllim. Komenteve që janë marrë nëpërmjet organeve të standardizimit, të cilat e kanë pranuar këtë kod, iu jepet përgjigje sa më shpejt të jetë e mundur, nëse kjo gjë kërkohet. Përgjigja duhet të përfshijë shpjegimin përse ka qenë e nevojshme devijimi nga standardi përkatës ndërkombëtar.

13. Standardi botohet menjëherë sapo të jetë adoptuar dhe miratuar.

14. Me kërkesën e çdo pale të interesuar brenda territorit në një vendi anëtar të OBT-së, DPS-ja i jep menjëherë ose merr masa për t'iu dhënë, një kopje të programit më të fundit të punës ose të një standardi i cili është përgatitur. Çdo pagesë për këtë shërbim është e njëjtë si për subjektet e vendit, ashtu edhe për ato të huaja.

15. Për qëllime të këtij Kodi, tarifat për çmimet e shërbimeve që DPS-ja kryen ndaj të tretëve miratohen nga Ministria e Financave me propozimin e DPS-së.

VENDIM

Nr. 191, datë 13.3.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 150, DATË 22.3.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KONCESIONEVE (ATRAKO)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 150, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, fjalët "... person juridik, publik ..." zëvendësohen "... institucion buxhetor ...".

2. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Shuma që do të paguhet për shërbimet e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), shpallet në dokumentet e garës dhe paguhet nga koncesionari fitues, si më poshtë vijon:

a) Për projektet koncesionare deri në 5 000 000 (pesë milionë) euro, shuma e pagueshme është 5 000 (pesë mijë) euro.

b) Për projektet koncesionare mbi 5 000 000 (pesë milionë) euro deri në 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) euro, shuma e pagueshme është 10 000 (dhjetë mijë) euro.

c) Për projektet koncesionare mbi 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) euro deri në 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro, shuma e pagueshme është 20 000 (njëzet mijë) euro.

ç) Për projektet koncesionare mbi 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro, shuma e pagueshme është 30 000 (tridhjetë mijë) euro."

3. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. Të ardhurat e përfituara sipas pikës 7 të këtij vendimi, derdhen në buxhetin e shtetit."

4. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), financohet nga buxheti i shtetit. Buxheti i ATRAKO-s miratohet me buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si zë i veçantë."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij nga data 22.3.2009 e në vijim.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 192, datë 13.3.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS STRAVAJ TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshillit të Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Stravaj, të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Stravaj, të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr. 299, datë



12.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Stravaj, të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Stravaj për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Stravaj	Lidhja nr.1	
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
2-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
11,18,20,22,23,39-48,72	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
75-103	Varrezat publike	Në pronësi
50-52,104-201	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
214,215,217,218,220,221, 223-225,227,228	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
216,219,222,226,229	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
16,21,24,25, 28-37,49,53-69,70,71	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim

VENDIM

Nr. 197, datë 22.2.2012

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 442, DATË 18.4.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË PALËS SHQIPTARE, PJESËMARRËSE NË OPERACIONIN USHTARAK “ALTHEA”, TË BASHKIMIT EUROPIAN, NË BOSNJË-HERCEGOVINË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të Bashkimit Europian për menaxhimin e krizës në Bosnjë-Hercegovinë (operacioni “ALTHEA”), ratifikuar me ligjin nr. 9392, datë 12.5.2005, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas shkronjës “b” të pikës 1 të vendimit nr. 442, datë 18.4.2008 të Këshillit të Ministrave, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) shpenzime për zhvillimin e aktiviteteve social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 198, datë 22.2.2012

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 13, DATË 7.1.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR CAKTIMIN E SHPËRBLIMIT DITOR PËR USHTARAKËT E
FORCAVE TË ARMATOSURA TË DËRGUAR NË BOSNJË-HERCEGOVINË, NË
KUADËR TË OPERACIONIT USHTARAK “ALTHEA”, TË BASHKIMIT EUROPIAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të aktit normativ nr. 2, datë 8.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për dërgimin në Bosnjë-Hercegovinë të një grupi të asgjësimit të municioneve dhe eksplozivëve të Forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, për të marrë pjesë në operacionin “ALTHEA” të Bashkimit Europian, miratuar me ligjin nr. 9907, datë 24.4.2008, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 1 të vendimit nr. 13, datë 7.1.2010 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1.1 me këtë përmbajtje:

“1.1. Kohëzgjatja e misionit të jetë deri në fund të vitit 2013, me rotacion çdo 6 (gjashtë) muaj. Rotacionit i shtohet edhe koha e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 200, datë 21.3.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 839, DATË 5.12.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË PROCEDURAVE PËR
RIMBURSIMIN E AKCIZËS SË PAGUAR DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE LEHTËSUESE,
PËR NDËRTIMIN E BURIMEVE TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, ME
FUQI TË INSTALUAR JO MË PAK SE 5 MW”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 8987, datë 24.12.2002 “Për krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 839, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Në pikën 7 bëhen këto ndryshime:

“i) në paragrafin e parë, fjalët “... në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ...” zëvendësohen me: “... , brenda datës 10 të muajit pasardhës, në drejtorinë rajonale ku është i regjistruar ...”;

ii) në shkronjën “a” fjalët “... për një periudhë tremujore ...”, zëvendësohen me “ ... për një periudhë njëmujore ...”.

b) Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Rimbursimi i akcizës për lëndën djegëse të konsumuar, të llogaritur sipas formulës, bëhet në mënyrë automatike, nga drejtoria rajonale e tatimeve ku është i regjistruar subjekti, nga llogaria e veçantë buxhetore e krijuar nga kjo drejtori për këtë qëllim.

12.1. Brenda datës 10 të muajit pasardhës, subjekti paraqet kërkesën për rimbursim. Me paraqitjen e kërkesës për rimbursim nga subjekti, drejtoria rajonale tatimore, ku subjekti është i regjistruar, është e detyruar të kryejë rimbursimin automatik të shumës së kërkuar, në rast se kërkesa për rimbursim plotëson kushtet e mëposhtme:

a) subjekti nuk bën kërkesë për rimbursim për herë të parë;

b) është audituar në 3 (tri) vitet e fundit;

c) nuk ka asnjë detyrim tatimor ose kontribute të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore apo penalitete pa u paguar;

ç) ka deklarim të rregullt të TVSH-së dhe s’ka penalizime.

12.2. Kërkesa për plotësimin e kriterëve të mësipërme për rimbursimin automatik vlerësohet dhe procedohet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga inspektorët e drejtorisë rajonale tatimore. Kërkesit për rimbursim mund të kontaktohen për të sqaruar problemet, por dokumente shtesë, përveç atyre të kërkuara në këtë pikë, nuk do të kërkohen. Ato kërkesa që nuk plotësojnë kushtet do të dërgohen për kontroll dhe kërkesit mund t’i kërkohet të paraqesë dokumente shtesë.

12.3. Në rast se kërkesa për rimbursim paraqitet nga një person i tatueshëm për herë të parë, organi tatimor duhet të verifikojë në vend saktësinë e shumës së rimbursimit të kërkuar dhe e miraton atë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Kontrolli i kërkesave për rimbursim bëhet duke respektuar radhën kohore të paraqitjes së kërkesave. Rimbursimi kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, pas miratimit të shumës për t’u rimbursuar.

12.4. Në rast se drejtoria rajonale tatimore, brenda 10 ditëve kalendarike, nuk procedon me rimbursimin automatik, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, në masën e akcizës së pretenduar për rimbursim.

12.5. Kontrolli i kërkesave për rimbursim bëhet duke respektuar radhën kohore të paraqitjes së kërkesave.

12.6. Në rast se gjatë kontrollit rezulton se ka pasur pasaktësi ose pavërtetësi të dokumenteve, subjekti përfitues i rimbursimit duhet ta kthejë të gjithë shumën e rimbursuar, ndërsa mbi të aplikohen penalitetet e përcaktuara në ligjin për procedurat tatimore.”.

c) Në pikën 13, fjalët “... jo më vonë se 45 ditë ...” zëvendësohen me “...jo më vonë se 5 (pesë) ditë...”.

2. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 201, datë 21.3.2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 7, DATË 4.1.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM PËR ARKËTIMIN E TAKSËS SË RENTËS MINERARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 7, datë 4.1.2012 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shitesa:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kur subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit shet për konsum final, brenda vendit, mineralin apo nënproduktin e prodhuar, renta minerare paguhet pranë organit tatimor brenda datës 15 të muajit pasardhës. Vlera që merret parasysh për aplikimin e rentës apo baza e taksueshme, mbi të cilën zbatohet renta, është vlera e deklaruar në faturën e shitjes së mineralit, në rastin e shitjes së mineraleve. Për përcaktimin e detyrimit të rentës, si dokument bazë shërben fatura tatimore me TVSH. Detyrimi për rentën, në rastin kur shitet mineral, përcaktohet duke shumëzuar përqindjen e rentës, sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, me vlerën totale të shitjeve. Në rastin e shitjes së produkteve/nënprodukteve që kanë përdorur lëndë të parë pasuri minerale vendase, në bazën e llogaritjes së rentës minerare përfshihet vetëm vlera e mineralit/mineraleve të përdorur për prodhimin e produktit/nënproduktit. Vlera deklarohet nga subjekti, ndërsa autoriteti tatimor ka të drejtë ta krahasojë këtë vlerë të deklaruar me vlerën referuese, sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin si lëndë të parë minerale.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:



“4. Kur subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit eksporton mineral, renta minerare paguhet në degët doganore, në çastin e bërjes së deklaratës doganore të eksportit, nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit, i cili është njëkohësisht dhe eksportues i produktit mineral që eksportohet. Vlera që merret parasysht për aplikimin e rentës apo baza e taksueshme, mbi të cilën aplikohet renta minerare, është vlera e faturës së shitjes së mineraleve, në bazë të çmimeve të eksportit, që është çmimi FOB në Shqipëri. Për përcaktimin e detyrimit të rentës, në këtë rast, si dokument bazë shërben fatura tatimore e shitjes me TVSH zero. Në rastin e eksportit të produkteve/nënprodukteve që kanë përdorur lëndë të parë pasuri minerale vendase, në bazën e llogaritjes së rentës minerare përfshihet vetëm vlera e mineralit/mineraleve të përdorur/a për prodhimin e produktit/nënproduktit. Vlera deklarohet nga subjekti eksportues, ndërsa autoriteti doganor ka të drejtë ta krahasojë këtë vlerë të deklaruar me vlerën referuese, sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin si lëndë të parë minerale.”.

3. Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. Lista me vlerat referuese, sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin minerale, hartohet dhe miratohet nga një komision *ad-hoc* i ngritur me urdhër të Ministrit të Financave. Komisioni, i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, drejtorive të përgjithshme të doganave e tatimeve, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore) dhe Fakultetit të Gjeologji-Minierave, brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ua përcjell zyrtarisht listën e miratuar autoriteteve doganore e tatimore, për t’u përdorur si burim i të dhënave të disponueshme. Ky komision mblidhet dhe përditëson listën sa herë është e nevojshme.”.

4. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe ajo e Tatimeve, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore), Fakulteti i Gjeologji-Minierave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 205, datë 21.3.2012

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTERIA E MBROJTJES TE
MINISTERIA E BRENDSHME, TË PRONËS NR. 818, ME EMËRTIM “BATERIA
KUNDËRAJRORE”, ME VENDNDODHJE NË MBYET, FIER, DHE PËR NJË NDRYSHIM
NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme, të pronës nr. 818, me emërtim “Bateria kundërajrore”, me vendndodhje në Mbyet, Fier, për t’u përdorur për vendosjen dhe sistemimin e Stacionit të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit në Fier.

2. Prona nr. 818, me emërtim “Bateria kundërajrore” në Mbyet, Fier, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave.

3. Ministrisë së Brendshme i ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 16.4.2012
Doli nga shtypi më 17.4.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 42 lekë